



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE MJEDISORE

DHE JETËSIMIT TË PRIORITETEVE

DREJTORIA E BIODIVERSITETIT DHE ZONAVE TË MBROJTURA

Nr 6050/ Prot.

Tiranë, më 21.9.2016

DREJTUAR: Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Lënda: Dërgohet Urdhër për botim

Bashkëlidhur lutemi gjeni për botim Regulloren nr. 182, datë 20.09.2016 të Ministrit të Mjedisit, “Për trajtimin e llojeve të faunës së egër në zooparqe dhe në mjedise të tjera, ku individët i ekspozohen publikut”

Lutemi botimin e Urdhërit në kohën më të shpejtë të mundshme.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !

Alqi Bllako
Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 6020 Prot.

Tiranë, më 20.9. 2016

URDHËR
Nr. 182, datë 20.9.2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES

“PËR TRAJTIMIN E LLOJEVE TË FAUNËS SË EGËR NË ZOOPARQE DHE NË
MJEDISE TË TJERA, KU INDIVIDËT I EKSPPOZOHEN PUBLIKUT”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjës "d" të nenit 28 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe në zbatim të nenit 26 pika 2 të ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

- Miratimin e rregullores “Për trajtimin e individëve të llojeve të faunës së egër në zooparqe apo në mjedise të tjera, ku individët i ekspozohen publikut”, sipas draftit që i bashkëlidhet këtij urdhëri, si pjesë përbërëse e tij.
- Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura dhe Drejtoria Juridike, e Komunikimit dhe Prokurimeve të dërgojnë urdhërin për botim pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, brenda 2 ditëve nga miratimi i tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.



RREGULLORE

PËR TRAJTIMIN E LLOJEVE TË FAUNËS SË EGËR NË ZOOPARQE DHE NË MJEDISE TË TJERA, KU INDIVIDËT I EKSPZOZHEN PUBLIKUT

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Rregullorja “Për trajtimin e individëve të llojeve të faunës së egër në zooparqe dhe në mjedise të tjera, ku individët i ekspozohen publikut” ka si që qëllim të mbrojë faunën e egër dhe të ruajë biodiversitetin, nëpërmjet masave të inspektimit të aktivitetit të Parqeve Zoologjike (zooparqeve) në territorin e Republikës së Shqipërisë.

KREU II

MASAT RUAJTËSE (KONSERVUESE) DHE MIRËMBAJTJA E KAFSHËVE

Neni 2

Masat ruajtëse (konservuese) që duhet të zbatojnë zooparqet

1. Zooparqet duhet të zbatojnë një sërë masash ruajtëse (konservuese):
 - a. Të marrin pjesë në kërkime, që do të çojnë në thellimin e njohurive, nga të cilat do të përfitojnë llojet; në trajnime për fushën e konservimit; në shkëmbimin e informacionit që lidhet me ruajtjen e llojeve dhe me shumimin në gjendje jo të lirë, ripullimin dhe riintroduktimin (rifutjen) e llojeve në jetën e egër;
 - b. Të promovojnë edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut dhe në shkolla për ruajtjen e biodiversitetit, duke ofruar informacione specifike për llojet e ekspozuara, për habitatet natyrore, për mundësitë dhe opsonet për planifikimin e rifutjes së tyre në natyrë, dhe në problematikat e konservimit të llojeve të ndryshme;
 - c. Të akomodojnë kafshët në kushte që synojnë të kënaqin kërkuesat biologjike dhe ato të ruajtjes, duke siguruar rrëthimin specifik sipas llojit dhe duke mbajtur një standard të lartë të kujdesit për to, nëpërmjet zhvillimit të një programi të kujdesit veterinar parandalues dhe kurativ si dhe të ushqimit;
 - d. Të kenë lloje të shëndetshëm dhe të përbushin nevojat biologjike të tyre, të garantojnë mirëqenien e tyre dhe ruajtjen e llojeve duke mundësuar edhe mbrojtjen e mjedisit;
 - e. Të sigurojnë mbajtjen dhe mbrojtjen e kafshëve nëpermjet programeve dhe trajtimeve veterinare e kurative duke ofruar një dietë të saktë;

- f. Të marrin masa për të parandaluar largimin e kafshëve në mënyrë që të shmanget kërcënimet ekologjike për llojet indigjene dhe të parandalohet përhapja e llojeve të huaja (invazive);
- g. Të mbajnë dhe të përditësojnë database-n dhe regjistrin për të gjithë individët e çdo lloji që gjenden në koleksionin e kopshtit zoologjik.

Neni 3

Mirëmbajtja e kafshëve, mirëqenia dhe shëndeti i tyre

1. Në zooparqe duhet të zbatohen rregullat e mëposhtme për të siguruar mirëqenien e kafshëve:
 - a. Vëzhgimi rutinë i kafshëve duhet të kryhet çdo ditë nga personeli i autorizuar;
 - b. Çdo lloj që paraqet situata stresi, është i sëmurë apo i plagosur, duhet t'i jepet ndihma e shpejtë dhe e specializuar nga mjeku veterinar;
 - c. Hyrja e vizitorëve në parkun zoologjik me mjete private lejohet vetëm në vendet e caktuara për parkim për të evitar shqetësimin e individëve në Parqe.

KREU III

MJEDISI, USHQIMI, KUJDESI VETERINAR DHE PROTOKOLLI PAS NGORDHJES SË KAFSHËVE

Neni 4

Hapësira, nevoja për ecje dhe bashkëjetesa me lloje të tjera

1. Individët e llojeve të faunës së egër duhen vendosur në territor të rrëthuara me gardhe, kafaze, apo në vaska në mënyrë të tillë që të lejojnë kryerjen e aktivitetit fizik, në bazë të përkatësisë llojore.
2. Gardhet, kafazet apo vaskat duhen dimensionuar në mënyrë efikase dhe llojet duhen menaxhuar në mënyrë që:
 - a. Të evitohet që llojet të krijojnë grupe dominante, të cilat nuk i përkasin llojit;
 - b. Të evitohen konfliktet midis llojeve;
 - c. Të ndalohet infektimi i individëve nga parazitë të ndryshëm.
3. Individët nuk duhen provokuar për të patur sjellje jashtë natyrës së tyre, për të përfituar argëtime nga ana e vizitorëve.
4. Shpërndarja e llojeve në territor të rrëthuara me gardhe, kafaze, apo në vaska të afërtë me njëra tjetrën bëhet në mënyrë të tillë që të mos bashkëveprojnë me njeri - tjetrin dhe të mos krijohet stres midis tyre.

5. Gardhet, kafazet dhe vaskat duhet të kenë hapësira të mjaftueshme dhe të ndara për femrat e mbarsura apo që kanë të vegjël në mënyrë të tillë që të evitohen situata të stresit apo të vuajtjes.
6. Largimi dhe izolimi i femrave të mbarsura apo i femrave me të vegjël duhet të bëhet vetëm me lejen e veterinarit apo të përgjegjesit të parkut zoologik.

Neni 5 **Kushtet e mjedisit**

1. Temperatura, ventilimi dhe drita e kafazeve duhet të jenë të përshtatshëm për të sigurar mirëqenie për çdo lloj në të gjithë jetën e tij. Në mënyrë të veçantë:
 - a. Duhen mbajtur me kujdes femrat e mbarsura, gati në lindje apo ato që sapo kanë lindur për të përm bushur të gjitha kërkesat e tyre fiziologjike;
 - b. Llojet e reja që do të futen në kopshtin zoologjik të introduktohen (rifuten) gradualisht në mënyrë që mos ketë probleme me ambientimin e tyre;
 - c. Vaskat për llojet detare duhen ajrosur duke mbajtur nën kontroll parametrat e ujit, i cili duhet të kenë standarde sanitare për të siguruar mirëqenien e llojeve;
 - d. Territorret e hapura të rrethuara me gardhe duhet të kenë strehime për të evitar shiun dhe diellin e fortë.

Neni 6 **Ushqimi**

1. Ushqimi dhe lëngjet duhet të kenë vlera ushqimore që t'i përgjigjen çdo individi të një lloji duke patur parasysh moshën, kushtet fizike dhe kushtet e përgjithshme shëndetësore.
2. Vëmendje të veçantë duhet të ketë për llojet, të cilët kanë trajtime mjekësore ose femrat gjatë kohës së mbarsjes.
3. Paketimi i ushqimeve duhet të kryhet në bazë të normave higjenike.
4. Duhet të ndalohet dhënia e ushqimeve nga vizitorët e parkut.
5. Ambientet e parkut duhen mbajtur në kushte higjeno sanitare të përshtatshme(duke përdorur produkte jo toksike) në të gjithë territorin e zooparkut dhe vaskat për të zvogëluar rrezikun e trasmetimit të sëmundjeve ngjitëse. Në rastin e vaskave me ujë duhet monitoruar cilësia kimike e ujit.

Neni 7 **Kujdesi veterinar për kafshët**

1. Në parqet zoologjike duhet që të ketë një asistencë veterinare.
2. Parku zoologjik duhet ketë një program për kujdesin shëndetësor, i cili zbatohet në praktikë vetëm nën kujdesin e veterinerëve.

3. Nën kujdesin e mjekëve veterinerë duhet të kryhen analiza rutinë, të cilat përfshijnë kontrollin ndaj parazitëve dhe kryerjen e vaksinimit në mënyrë të rregullt për çdo individ.
4. Parqet zoologjike duhet të garantojnë një asistencë të mjekut veteriner 24 orë në 24 gjatë gjithë javës.
5. Parqet duhet të kenë një vend të caktuar për kujdesjen e kafshëvë të lënduara, të sëmura apo të stresuara.

Neni 8

Protokolli pas ngordhjes së kafshëve

1. Kafshët e ngordhura duhet të menaxhohen në mënyrë të tillë që të parandalohet transmetimi i sëmundjeve ngjitëse tek kafshët e tjera.
2. Shkaku i ngordhjes së kafshëve duhet të identifikohet gjithnjë nga veterineri dhe kjo praktikë duhet të kryhet nëpërmjet autopsisë nga mjeku veterinar apo nga mjeku patolog.
3. Pas kryerjes së autopsisë duhet të procedohet me mënyrë të shpejtë për heqjen e karkasës dhe të organeve të brendshme.

KREU IV

MBROJTJA DHE SIGURIA

Neni 9

Rrethimi me gardhe

1. Të gjitha llojet duhen mbajtur në territor të rrethuara me gardhe ose në kafaze, përfshirë edhe ato lloje të cilët nuk janë të rrezikshëm.
2. Rrethimi i gardheve dhe kafazët duhet të projektohen, ndërtohen dhe të mirëmbahen në mënyrë të tillë që t'i përshtaten çdo lloji.
3. Llojet e rrezikshme të cilët mund të kapërcejnë gardhet duhet të mbahen në kafaze të myllura me rrjeta, me mure dhe me çati në mënyrë të tillë që të pengohet kapërcimi i tyre nga llojet e rrezikshme.
4. Llojet brejtëse duhet të mbahen në kafaze ose në territor të rrethuara me gardhe, të cilët pengojnë largimin e tyre.
5. Rrjetat që rrethojnë gardhet duhet të janë të salduara dhe të fiksuarë mirë në tokë.
6. Portat e kafazeve që strehojnë lloje të rrezikshme duhet të myllen në mënyrë të sigurt.
7. Vaskat për llojet ujore duhet të janë të projektura për të parandaluar rrezikun si për llojet e strehuara ashtu edhe për vizitorët.

Neni 10
Barrierat

1. Në zonat ku ekspozohen lloje te rrezikshme duhet te instalohet një barrierë ndarëse për vizitorët, për të parandaluar kontaktin e mundshëm.
2. Barrierat për vizitorët duhen ndërtuar në mënyrë të tillë që fëmijët e vegjël të mos e kalojnë apo të kapërcejnë gardhin.

Neni 11
Gardhet perimetrale

Gardhet perimetrale duhet të projektohen, ndërtohen dhe mirëmbahen në mënyrë të tillë që të mos inkurajojnë vizitoret që t'i kapërcejnë ato. Asnjë gardh perimetral nuk duhet të jetë i elektrizuar ose të ketë një lartësi më të madhe se 2 metra.

KREU V
SINJALISTIKA DHE SIGURIA PËR VIZITORËT

Neni 12

Sinjalistika për vizitorët

1. Çdo territor i rrethuar me gardh dhe kafaz, që akomodon lloje të rrezikshme, duhet të ketë lajmërim me tabela të dukshme dhe me animacion e përmasa të përshtatshme, që paralajmërojnë për rrezikun e mundshëm dhe që të mos kapërcehet gardhi apo kafazi.
2. Çdo gardh i elektrizuar duhet të ketë tabelë të afishuar, e cila duhet të paralajmërojë vizitorët për rrezikun.
3. Tabelat e paralajmërimit duhet të jenë të afishuara si brenda ashtu dhe jashtë gardhit.

Neni 13
Largimi i llojeve nga kafazet

1. Operatoret e kopshtit zoologjik duhet të jenë të trajnuar për të mënjanuar rrezikun, i cili mund të vijë si pasojë e arratisjës së individëve të llojeve nga kafazet.
2. Në rastet e largimit të llojeve nga kafazi zbatohen planet e emergjencës.

Neni 14

Siguria përvizitorët

1. Ndërtesat, strukturat dhe zonat që vizitohen nga publiku duhet të përmbushin kushtet e mëposhtme të sigurisë:
 - a. Vizitorëve i ndalohet hyrja në ndërtesa të cilat paraqesin rrezik për shëndetin apo për sigurinë e tyre;
 - b. Pemët në zonat ku vizitorët qëndrojnë apo ecin duhen kontrolluar, krasitur dhe prerë.
 - c. Pranë ambienteve ujore duhet të vendosen tabela informuese për të shmangur incidente të mundshme me vizitorët.

Neni 15

Emergjencat

1. Në parqet zoologjike, të cilat stehojnë lloje helmuese me qëllime konservimi (ruajtjeje), duhet të ruhen në mënyrë korrekte antihelmet, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë së tyre.
2. Personeli duhet të trajnohet për kryerjen e procedurave në raste kur vizitori pickohet nga lloje helmuese.
3. Trajnim i duhet të trajtojë:
 - a. Procedurën e menjëherështe të ndihmës së shpejtë për kurimin e pacientit (vizitorit);
 - b. Përshkrimin në detaje të zonës së pickimit dhe të llojit që ka pickuar vizitorin;
 - c. Emrin e antihelmit gjatë kohës së ndihmës së shpejtë.

KREU VI

KONTROLLI DHE INSPEKTI

Neni 16

Organet e kontrollit

1. Kontrolli dhe inspektimi i Parqeve Zoologjike duhet të kryhet të paktën një herë në vit nga organet inspektuese te ngarkuara me ligj.
2. Çdo zoopark mban bazën e të dhënavë (database) të llojeve prezente që strehon sipas formatit në Shtojcën 1, bashkëlidhur kësaj rregullore.
3. Të dhënat e inspektimit për çdo zoopark, raportohen në Drejtorinë e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura pranë Ministrisë së Mjedisit dhe përditësohen rregullisht.

SHTOJCA 1

DETABASE ITË DHËNAVE NË PARQET ZOOLOGJIKE\ EMËRTIMI I PARKUT